

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

« **ELDA – VL** » shpk

Sot me date 20.05.2011 (dymijë e njëmbëdhjete) , unë ortaku i vetëm : **ARTAN HOXHAI** , shtetas shqiptar i biri i Dane dhe i Nefize ,lindur me 06.09.1973 ne Ramice Vlore e banues ne Lagjen „ Hajro Çakerrri „ rruga „ Seh Zeneli „, Nr 88 Vlore, mbajtes i leternjoftimit ID me Nr 025020700, lëshuar me date 21.04.2009 bazuar ne legjislacionin shqiptar :

Vendosa

Te ndryshoje Statutin e shoqërisë « **ELDA – VL** » shpk ne baze te legjislacionit shqiptar në fuqi, Ligji 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Nëni 1

EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

Shoqërinë « **ELDA – VL** » sh.p.k eshte Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar .

Nëni 2

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Shoqëria « **ELDA – VL** » sh.p.k do te veproje për një periudhe kohe me shume se 20 vjet .

Nëni 3

QENDRA (SELIA)


Shoqëria « **ELDA – VL** » sh.p.k do te ketë qendrën (selinë) e saj ne adresën , lagja „ „ Hajro Çakerrri „ rruga „ Seh Zeneli „, Nr 88 Vlore
Shoqëria ka të drejtë të hapi degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nëni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare “**ELDA – VL** ” shpk është si më poshtë:
- Import , eksport ,tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem, transportin e pasagjereve e mallrave , hapjen e servileve , kryerjen e punimeve te ndertimit, ushtrimin e aktivitetit ne fushën e ndërtimit.
 - Shoqëria ka te drejte te ushtroje te gjitha ato aktivitete cilat ne mënyre direkte apo indirekte përputhen me objektin e mësipërm

Nëni 5



REGJIMI JURIDIK.

Ne te gjithë territorin e saj ne Republikën e Shqipërisë. Shoqëria do te udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim te plote ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per evidentimin e veprimtarisë se Shoqërisë do te përdoren dispozitat ligjore ne fuqi, dhe kërkohet e përgjithshme te kontabilitetit ,siç sqarohet me hollësisht ne dispozitat përkatëse te Statutit te Shoqërisë

Shoqëria gëzon afirmimin ligjor qe nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane .

Neni 6

KAPITALI I SHOQËRISË

6/1 Kapitali baze i Shoqërisë është :

Ne para – 100.000 lek, i barabarte me 100 kuota ,me vlere nominale 1.000,00 leke secila , teresisht prone e ortakut te vetem , i depozituar ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi .

6/2 Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike ,financiare si dhe vendimeve qe do te marr une ortaku i vetem i saj , per ta rritur ate ne te ardhmen

6/3 Ne rast vdekje te ortakut pasuria u kalon trashegimtareve te tij sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

Neni 7

DREJTIMI I SHOQËRISË

7/1 Fillimisht Shoqëria do te udhëhiqet, administrohet dhe drejtohet nga Administratori i shoqërisë i cili është z. **Artan Hoxhaj** per nje periudhe 5 vjecare . e cila do te përfaqësoje shoqërinë ne maredhenjet me te tretet .

7/2 Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise do te vendosim zgjercimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit ekonomik .

7/3 Per cdo ceshtje profesionale ,si juridike ,ekonomike ,teknike etj ,shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar specialist sipas legjislacionit ne fuqi .

7/4 Kompetencat kryesore te ortakut te vetëm do te jene :

1. Bej ndryshime ne aktin e themelimit
2. Bej ndryshime ne objektin e veprimtarisë
3. Miratoj rezultatet vjetore te Shoqërisë
4. Riorganizoj , zgjeroj e mbyll shoqërinë .
5. Miratoj projekte për zgjerimin dhe materializimin e veprimtarise se Shoqërisë .
6. Miratoj raportin vjetor te veprimtarisë se kryer nga Administrata e Shoqërisë .
7. Emëroj dhe shkarkoj nga detyra personelin e shoqërisë dhe u përcaktoj shpërbllimin qe do u jepet ne përputhje me legjislacionin ne fuqi .

Neni 8

DISPOZITAT EKONOMIKE





8/1 Veprimtaria ekonomike – financiare dhe tregtare e shoqërisë realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë .

8/2 Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregtar dhe juridik me persona te trete shoqëria përgjigjet me pasuritë e veta .

8/3 Aktivi dhe pasivi i veprimtarisë se Shoqërisë pasqyrohet ne planet ekonomike – financiare dhe tregtare te saj te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj .

8/4 Pasuritë e shoqërisë vlerësohen nëpërmjet bilanceve ekonomiko- financiare dhe tregtare te saj .ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi .

8/5 Te ardhurat e shoqërisë pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurisë se palujtshme dhe te lujtshme si dhe shpenzimet e tjera qe bëhen ne interes te shoqërisë ,me takojnë mua ortakut te saj sipas dispozitave te përcaktuara ne aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te saj .

8/6 Per detyrimet shoqëria përgjigjet me fondet e veta .

8/7 Pasuria e shoqërisë do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikës si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi .

8/8 Masa e pasurisë qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga une ortaku i vetem .

Neni 9

LLOGARIA E SHOQERISE

9/1 Shoqëria llogarinet rrjedhese te saj e ka ne BKT. Ajo mund te cel edhe llogari te tjera rrjedhese .

9/2 Shoqëria l mban llogarite ne lek shqiptare ose ne valute te huaj , sipas rastit qe i paraqitet per veprime te ndryshme monetare .

9/3 Te gjitha shpenzimet e shoqërisë ne lek apo ne valute ,sigurohen nga arketimet e shërbimeve dhe veprimeve qe pasqyrohen ne Objektivin e veprimtarisë se saj ose nga menyra te tjera qe lejon legjislacioni ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë .

Neni 10

VITI EKONOMIK

Viti ekonomik fillon ne 1 Janar te cdo viti kalendarik dhe perfundon ne 31 Dhjetor te atij viti.


Neni 11

DHENIA E LLOGARISE EKONOMIKE

11/1 Shoqëria funksionon ne baze te dispozitave ligjore ekonomike ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë ,te dispozitave te Aktit te Themelimit dhe te Statutit te krijimit te saj .si dhe programeve te vecanta qe do te hartoj une Ortaku i saj per cdo vit ekonomik .

11/2 Llogaria ekonomike e shoqërisë mbështetet ne llogarite e shërbimeve dhe te vetfinancimeve qe mbulon shpenzimet e veta .

11/3 Per nxitjen ekonomike te veprimtarisë se shoqërisë do te krijohen fonde rezerve dhe fonde te tjera te vecanta ne përputhje me mundësitë ekonomiko financiare dhe tregtare te saj



11/4 Shoqëria do të mbaje kontabilitet në baze të rregullave ,metodave teknike kontabël në gjuhën shqipe dhe në lek shqiptare .Për mbajtjen e kontabilitetit do të përdoren Libri Ditar ,Libri I Madh ,Libri Inventar etj .

11/5 Cdo formë organizimi e kontabilitetit do të mbahet e tillë që të mundësojë kryerjen e kontrollit të jashtëm në mënyrë të tillë që çdo ekspert kontabël të nxjerre nga librat kontabël një pamje të përgjithshme të veprimeve të kryera dhe veprimtarisë së shoqërisë .

Neni 12

RAPORTI VJETOR

Raporti vjetor i veprimtarisë së shoqërisë do të paraqitet në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në Ligjin 9901 ,date 14.04.2008 Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ .

Neni 13

RASTET E NDERPRERJES SË VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Une ortaku i vetëm i shoqërisë kam të drejtën e ndërprerjes së marrëdhënjëve që rrjedhin nga Statuti dhe Akti i Themelimit të Shoqërisë kur për këtë vertetohen arsye serioze siç mund të jenë :

1. Veprimi i kushteve të forcave mëdha
2. Varferimi i shoqërisë
3. Dalja e një vendimi nga Organet kompetente që ndalon veprimtarinë e saj .
4. Marrja e vendimit përkatës nga une Ortaku i vetëm .

Neni 14

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

14/1 Në rast se në Republikën e Shqipërisë shpallen ligje ,dekrete, ose vendoset një politikë me të favorshme nga legjislativi i pasqyruar në Aktin dhe Statutin e krijimit të Shoqërisë atëherë une ortaku i saj kam të drejtën të drejtohem i organeve përkatëse shtetërore që të zbatojnë legjislativin me të favorshëm për mua dhe shoqërinë e krijuar nga unë ortaku i vetëm i saj .

Neni 15

ZGJIDHJA E MOSMAREVESHJEVE

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis personave të ndryshëm të shoqërisë do të jetë me mirëkuptim ,e nëse kjo nuk arrihet atëherë pala e interesuar mund të drejtohet organeve kompetente të juridiksionit të vendit ku kanë lindur mosmarrëveshjet .


Neni 16

DISPOZITA TË VECANTA

16/1 Të gjitha dokumentat e shoqërisë do të përmbajnë adresën e plotë të saj ,numrin e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit të biznesit si dhe Numrin e Regjistrimit në Organin Tatimor të njësisë ku do të ushtroje veprimtarinë e saj .

16/2 Për çështje të tilla që nuk parashikohen në Statut ,veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në legjislativin përkatës në Fuqi në Republikën e Shqipërisë .

Ligji 9723, date 03.05.2007,, Për qendrën Kombëtare të regjistrimit ,, , si dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008 ,, Për tregtarët e shoqëritë tregtare ,,



Neni 17

HYRJA NE FUQI


17/1 Ky Statut i përpiluar nga une Ortaku vetëm i saj ne pese kopje te barabarta ,hyn ne fuqi qysh ne momentin e nënshkrimit nga ana ime ne Zyrën Noteriale Vlore ku depozitohet edhe kopja e pare .

17/2 Ne rastet e likuidimit përfundimtarë te shoqërisë ,sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruari edhe ky Statut i saj .

17/3 Krahas persosjes se mëtejshme te legjislacionit tregtar ,si dhe te ecurise se veprimtarise se shoqërisë ,unë Ortakui vetem i saj kam te drejten e pemi-resimit te mtejshem dhe te dispozitave te ketij Statuti dhe te te gjithë dokumenteve te Shoqërisë duke bere depozitimet përkatëse sipas legjislacionit ne fuqi .

17/4 Statuti i mesiperm u nenshkrua sot me date 20.05.2011

ORTAKU I VËTËM I SHOQERISE

Artan Hoxhaj




Taksa e pulles u aplikua ne ~~4000~~ e noterit 200 leke .

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA VLORE
NOTERE SAIMIRA HOXHA

VLORE me 20.05.2011
Rep. 625
Kol 588 //

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 20.05.2011 u paraqit para meje Noteres se rrethit VLORE ,Saimira Hoxha personalisht shtetasi shqiptare :

Artan Hoxhaj, qytetar shqiptar, i biri i Dane dhe i Nefize, lindur në Ramice Vlore , më 06.09.1973, e banues në lagjen Hajro Çakerri, rruga Sheh Zeneli, Nr 88 Vlorë ,Shqipëri, mbajtes i leternjoftimit ID me Nr 025020700, leshuar me date 21.04.2009.

I cili me vullnet te lire dhe me deshiren e plote te tij nenshkruan kete *Statut te ndryshuar te Shoqërisë „ ELDA - VL ”* shpk ne baze te legjislacionit shqiptar në fuqi, Ligji 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.

Une Noterja pasi e gjej aktin e sipershenuar konform vullnetit te kerkuesit e legalizoj ate dhe e vertetoj rregullisht konform ligjit .

NOTERE
SAIMIRA HOXHA

